

**Nr. Prot. 065/B/18****VENDIM Nr. 1279****Për****Fillimin e procesit të Konsultimit Publik të draft dokumentit  
‘Përlllogaritja e Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit (WACC) për sektorin e telefonisë  
mobile në Kosovë’**

Në mbështetje të neneve; nenit 3, paragrafët 1) dhe 3), neni 9 paragrafi 3.3), nenit 10, paragrafi 4), nenit 79, paragrafët 1) dhe 2), nenit 82, paragrafët 1) dhe 3) të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - ARKEP ose Autoriteti*), Bordi i Autoritetit në përbërje prej:

- 1) z. Kreshnik Gashi, Kryetar
- 2) z. Bahri Ademaj, Anëtar
- 3) z. Hazir Hajdaraj, Anëtar
- 4) z. Nijazi Ademaj, Anëtar
- 5) z. Shqiprim Pula, Anëtar

në mbledhjen e 33-të me radhë të mbajtur më datë 10 Dhjetor 2018, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (*DKE*), nxjerr këtë;

**V E N D I M**

- I. Miratohet fillimi i Konsultimit Publik të dokumentit ‘**Përlllogaritja e Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit (WACC) për sektorin e telefonisë mobile në Kosovë’**.
- II. Procesi i konsultimit publik fillon më datë; **19 Dhjetor, 2018** dhe përfundon më **18 Janar, 2019**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A R S Y E T I M**

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: “*Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.*”

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t'i publikoj ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Korniza Rregullatore për Komunikimet Elektronike në Bashkimin e Evropian (BE) kërkon nga Autoritetet Rregullatore që periodikisht të rishikojnë tregjet e komunikimeve elektronike dhe vlerësojnë nevojën e vendosjes së detyrimeve rregullatore, përfshirë kontrollin e çmimeve për operatorët me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT), ashtu që të sigurohet konkurrenca efektive. Sidoqoftë, operatorët e përcaktuar si OFNT u lejojnë të arrijnë një normë të arsyeshme të kthimit në investimet e tyre (Ref. Neni 13 i Direktivës së Qasjes), e cila zakonisht matet nëpërmjet WACC-së.

Për të kryer funksionin e tij që ia jep Ligji nr. 04/L -199 për komunikime elektronike, dhe për të adresuar çështjet që lidhen me këtë treg, ARKEP duhet të përcaktoj rregulla dhe të krijoj stimuj që sigurojnë parakushte të barabarta të konkurrencës të gjithë aktorët në tregun e komunikimeve elektronike. Si një nga mekanizmat për të kryer funksionin e tij ARKEP e përdor metodën e WACC për të përlllogaritur dhe përcaktuar normën e kthimit të investimeve të operatorëve në tregun e komunikimeve elektronike, që është krijuar si një praktikë në mesin e autoriteteve rregullatore kombëtare.

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshilla Juridike;**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

**Prishtinë, 19/12/2018**

#### **Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Kreshnik Gashi**  
**Kryetar i Bordit**

#### **Aktvendimi i dërgohet;**

- Operatorëve (ndërmarrësve) të rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Departamentit Ligjor (DL),
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike (DKE),
- Arkivës së Autoritetit